



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 735 Prot.

Tiranë, më 02.12.2016

V E N D I M

Nr. 150, datë 02/12/2016

Për përfundimin e procesit të verifikimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1,14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; neneve 77-97, të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe nenit 34 të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të ardhur nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave me shkresën Nr.5839/1, datë. 18.11.2016, në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 88, dt.25.07.2016 "*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil*", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

Vërej se:

Me Vendimin Nr. 138, datë 30.12.2015 "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil*", Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar mbikëqyrjen e përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr.88, datë 25.07.2016 "*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil*" të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe administrimit të Ujërave, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.

2. Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, të kërkojë nga njësia përgjegjëse, (DAP), që të japë mendimin lidhur me përshkrimet e punës, nëse janë të hartuara në përputhje me legjislacionin specifik të fushës, apo formatin standard të miratuar. Pas kësaj, një kopje e përshkrimeve të punës të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të mësipërm, Ministria e Bujqësisë , Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave me shkresën Nr. 5839/1 prot., datë 18.11.2016, ka informuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 88, datë 25.07.2016.

Pas verifikimit të dokumentacionit shkresor të administruar nga ana e Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, rezultoi se:

- ✓ Njësia përgjegjëse në zbatim të pikës 2 të vendimit ka njoftuar me shkresën Nr. 5839/1 prot., datë 18.11.2016, se përshkrimet e punës janë depozituar pranë Departamentit të Administratës Publike. Përfundimisht, pas verifikimit të dokumentacionit të administruar dilet në konkluzionin se Vendimi nr. 88, datë 25.07.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil”*, është zbatuar plotësisht nga ana e subjektit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit nr. 88, datë 25.07.2016 në institucionin e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 88, datë 25.07.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”*

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave , Departamenti i Administratës Publike, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA